


Buletini

MAJ 2023



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net

Drejtuar nga Kryetari i Komunës, Imri Ahmeti, u mbajt mbledhja konsultative e Bordit të Drejtorëve



Në këtë takim është diskutua për dinamikën e shpenzimit të buxhetit dhe realizimin e të hyrave vetanake sipas planifikimit buxhetor, lidhur me mbarëvajtjen e punëve dhe projekteve në teren, niveli i shërbimeve administrative dhe shërbimeve publike dhe çështje të tjera organizative.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, së bashku me Kryetarin e Bashkësisë Islame në Lipjan, Zaim Baftiu kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për financimin e shërbimeve të varrimit



Komuna e Lipjanit do të vazhdojë të bëjë mbulimin e shpenzimeve për procesin e varrimit për qytetarët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Lipjanit, në shumë prej 280 euro të secilit rast.

Kryetari KBI-Lipjan, Zaim Baftiu, ka falënderuar Kryetarin Imri Ahmeti për bashkëpunimin, duke u shprehur shumë falënderues për gjithë angazhimin e tij për t'ju dalur në ndihmë qytetarët edhe në rastet e vdekjes së familjarëve të tyre.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim Drejtoreshen e aktivitetit të USAID-it, Qeverisja e Pronës, znj. Jennifer Ober



Me këtë rast, Kryetari z. Imri Ahmeti, theksoi se do të vazhdojmë bashkëpunimin e mirë edhe më tutje në përmbushjen e objektivave që ka projekti, njëherit ai ka falënderuar ekipin e USAID-it për bashkëpunimin dhe asistimin në sektorë të ndryshëm në ndërtimin dhe ngritjen e standardeve të punës si dhe në ndërtimin e veglave dhe rekomandimeve që do të na shërbejnë si udhërrëfyes për një menaxhim edhe më efikas.



Nga ana tjetër drejtoresha znj. Jennifer Ober, ka falënderuar Kryetarin Ahmeti dhe ekipen e tij për bashkëpunimin e mirë që kanë treguar në zbatimin e projektit.

Nënkryetari i komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi së bashku me bashkpunëtorë kanë bërë mbjelljen e luleve sezonale në hapësirat publike në qytetin e Lipjanit



Në kuadër të projektit të mirëmbajtjes së hapësirave publike në Komunën e Lipjanit, sot ka filluar procesi i mbjelljes së luleve sezonale në hapësirat publike në qytetin e Lipjanit.



Edhe këtë vit sikurse viteve të tjera Komuna e Lipjanit do t'i kushtoj vëmendje të veçantë ambienteve publike në mënyrë që këto hapësira në vazhdimësi të kenë pamje edhe më të mirë, po ashtu është shumë e rëndësishme që këto lule dhe çdo hapësirë tjetër e gjelbëruar të ruhet dhe mos të dëmtohet.

Kryetari, Imri Ahmeti ka mbajtur takim me përfaqësuesit e komunës në kuvendin e Aksionarëve të Ndërmarrjes Pastrimi, anëtarin e bordit të kësaj ndërmarrje dhe drejtorët kompetent nga Komuna e Lipjanit.



Të pranishmit u dakorduan që të negociohet tutje sipas ligjeve në fuqi për pavarësimin financiar të njësisë në Lipjan të ndërmarrjes KRM “Pastrimi”. Po ashtu u dakorduan që takime të tilla të jenë të rregullta për të shqyrtuar gjendjen e ndërmarrjes dhe ambientit në Komunën e Lipjanit.



Temë e këtij takimi ishte edhe mundësia e ndarjes së një lokacioni të ri për KRM “Pastrimi” - Njësia në Lipjan me qëllim të vendosjes së transferit të përkohshëm të mbeturinave dhe mekanizmit të ndërmarrjes në një pronë të veçantë.

Kryetari Imri Ahmeti, priti në takim myftiun e Kosovës Naim Tërri

Kryetari i Komunës, Imri Ahmeti ka pritur në takim kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiun Naim Tërri, i cili shoqërohej nga kryetari i BI-së në Lipjan, Zaim Baftiu dhe bashkëpunëtorë të tjerë, me të cilin kanë biseduar për një bashkëpunim sa më të frytshëm në shërbim të qytetarëve.



Me këtë rast, kryetari Ahmeti, ka potencuar nivelin e lartë të bashkëpunimit me Bashkësinë Islame, me imamët dhe me xhematin në Lipjan, në mënyrë që së bashku të kontribuojnë në mirëqenien e të gjithë qytetarëve pa dallim si dhe në kultivimin e harmonisë dhe tolerancës ndërfetare e që tani është në nivelin e duhur në Komunën e Lipjanit, ka thënë ndër të tjera Kryetari Ahmeti.



Nga ana tjetër, myftiu, Naim Tërri, theksoi se kjo është një përgjegjësi shumë e madhe, por edhe privilegj të jesh në shërbim të qytetarëve duke e vlerësuar edhe vullnetin e Komunës së Lipjanit për një bashkëpunim të mirë me Bashkësinë Islame.

Kryetari i komunes së Lipjanit bashkë me Presidenten e Republikës së Kosovës znj. Vjosa Osmani Sadriu, kryetarin e Suharekës z. Bali Muharremaj e afaristin z. Shaqir Palushi hapëm dyert e fabrikës së letrës higjenike dhe ambalazhit të letrës- Freesia në Lipjan nga Fondacioni Golden Eagle.



Kjo fabrikë është e veçantë sepse do të punojnë personat me aftësi të kufizuara, e nga fitimi do të sigurojnë mbështetje financiare dhe humanitare për të gjithë njerëzit në nevojë.



Lipjani jo vetëm për nga pozita gjeografike por edhe për nga ambienti i të bërit biznes po bëhet gjithnjë e më atraktive për investime në biznes.

Kryetari i komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti së bashku me bashkpunëtorë ka vizituar disa prej projekteve punimet e të cilave janë duke vazhduar ende.



Shkolla fillore në Ribar të Madh pritet të përfundojë këtë vit, një shkollë e cila do të ofroj ambient dhe një satandard modern.

Gjithashtu kryetari Ahmeti ka vizituar punimet në ndërtimin e çerdhes për fëmijë në Shalë dhe Rufc të Ri, e të cilat priten të përfundojnë gjatë këtij viti, me ç'rast fëmijëve të këtyre lokaliteteve do t'u ofrohen kushte më të mira për edukim parafillor.



Edhe në Gllogovc po punohet në ndërtimin e palestrës sportive, po ashtu shumë shpejt do të fillojë edhe ndërtimi i sallave të sporteve në Lipjan tek Shkolla "Ismail Luma" si dhe në Banullë.

Të gjitha këto projekte po ndërtohen nga buxheti i komunës së Lipjanit

Në nderim të përvjetorit të rënies së Heroit Halil Meta, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Daut Azemi me bashkëpunëtorë të tjerë, ka bërë homazhe dhe ka vendosur lule tek pllaka përkujtimore në Krojmir.

Në Shkollen Fillore të Mesme të Ulët, në fshatin Krojmir është kremtuar Ditën e Shkollës.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti së bashku me drejtorin e DKA-së z. Rasim Hasani kanë pritur në takim nxënësit dhe personelin menaxherial e arsimor të shkollës fillore “Vëllezërit Frashëri” të cilët do të marrin pjesë në garat në Genius Olympiad në qytetin Osvego në shtetin e New York të SHBA-së.



Me këtë rast, Kryetari i Komunës theksoi që edhe viteve të kaluara kemi mbështetur financiarisht nxënësit garues në gara ndërkombëtare si në New York të SHBA-së, Najrobi të Kenias etj. Komuna e Lipjanit, nxënësit pjesëmarrës në garat e këtij viti do t'i mbështesë në vlerë prej 10,000 euro.



Kryetari i inkurajoj dhe uroj nxënësit dhe mësimdhënësit për arritjet e tyre në gara të ndryshme në Robotikë. Suksesi juaj është vlerë dhe sukses për Lipjanin dhe arsimin në Kosovë.

Lipjani me transparencë të lartë në Indeksin e Transparencës për Qeverisjen Komunale për vitin 2022

Në një ceremoni të organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në bashkëpunim me Transparency International Slovakia, është prezantuar “Indeksi i Transparencës për Qeverisjen Komunale për vitin 2022”, për 38 Komunitet të Kosovës, ku Komuna e Lipjanit e udhëhequr nga Kryetari Imri Ahmeti është pjesë e top komunave më transparente në nivel vendi.



INDEKSI I TRANSPARENCËS NË QEVERISJEN KOMUNALE 2022

	Komuna / Politika qeverisëse	Prokurimi Publik në nivel komunal	Buxheti dhe financat publike	Dasia në dokumente dhe informacionin publik	Pjesëmarrja publike	Grantet dhe subvencionet	Etika Profesionale dhe Konflikti i Interesit	Menaxhimi i pronës komune dhe Anketat	Ndërmarrjet dhe organizatat komunale	Pikët e përmblidhura për komunë
	Pikët maksimale	15	15	15	15	10	10	10	10	100.00
1	Skenderaj	15.00	11.54	13.85	13.50	10.00	10.00	10.00	8.75	92.63
2	Lipjan	15.00	10.38	15.00	12.00	10.00	10.00	10.00	8.75	91.13
2	Mitrovicë	15.00	11.54	13.85	12.00	10.00	10.00	10.00	8.75	91.13
3	Prizren	15.00	11.54	13.85	13.50	10.00	8.00	10.00	8.75	90.63
4	Drenas	15.00	11.54	13.85	12.00	10.00	10.00	10.00	7.50	89.88
5	Prishtinë	15.00	11.54	13.85	12.00	10.00	8.00	10.00	8.75	89.13
6	Rahovec	15.00	10.38	12.69	13.50	11.11	10.00	10.00	6.25	88.94
7	Ferizaj	15.00	10.38	12.69	9.00	11.11	10.00	10.00	8.75	86.94
8	Gjakovë	15.00	11.54	13.85	12.00	10.00	8.00	10.00	5.00	85.38
9	Hani i Elezit	13.64	11.54	12.69	12.00	10.00	10.00	10.00	3.75	83.62
10	Dragash	15.00	10.38	13.85	12.00	10.00	4.00	10.00	7.50	82.73
11	Istog	15.00	10.38	12.69	7.50	8.89	10.00	10.00	7.50	81.97
12	Kacanik	13.64	11.54	12.69	9.00	10.00	10.00	10.00	5.00	81.87



Indeksi i transparencës në qeverisjen komunale për vitin 2022 e rendit komunën e Lipjanit në vendin e dytë të vlerësuar me 91.13 pikë, (nga maksimumi prej 100 pikëve në 87 treguesit e matur).

Duke uruar qytetarët për këtë rezultat, i cila është arritur si përpjeke e punës dhe angazhimit të përbashkët, Kryetari Ahmeti ka theksuar se do të vazhdojë punën me përkushtim në mënyrë që të vazhdojmë të jemi komuna më transparente dhe llogaridhënëse në nivel vendi.

Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 14-të me radhë



Në sallën e takimeve në Komunën e Lipjanit është mbajtur mbledhja e 14-të e Komitetit për Komunitete (KK) udhëhequr nga kryesuesi i komitetit Skender Bikliqi, ku janë shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës.



Në këtë mbledhje, Drejtori për Infrastrukturë, z. Sead Aliu i njoftoi të pranishmit rreth infrastrukturës lokale për projektet ku banojnë komunitete jo shumicë. Po ashtu gjate kësaj mbledhje është prezantuar edhe raporti i Zyrës Lokal për Komunitet.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim zv. drejtorin e aktivitetit të USAID-it, Qeverisja e Pronës, z. Ramadan Klisurica.



Gjatë këtij takimi është prezantuar Plani për Përmirësimin e Shërbimeve nga Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër si dhe një Udhëzues për Procesin e Inspektimit të Ndërtesave, dokumente këto që janë hartuar gjatë implementimit të projektit i cili po zbatohet në Komunën e Lipjanit nga Aktivitetit Qeverisja e Pronës të financuar nga Komuna e Lipjanit dhe USAID-i.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit Diamant Bytyqi, i shoqëruar me bashkëpunëtorë, kanë bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë lapidarit të Dëshmorit të Kombit Xhavit Kozhani, në fshatin Ribar i Madh në nderim të përvjetorit të rënies së tij.



Delegacioni nga Komuna e Lipjanit homazhe ka bërë edhe në varrezat e martirëve të këtij fshati si dhe në fshatin Zllakuqan.

Mbahet mbledhja e rregullt e KKSB-së



Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, kryesuar nga nënkryetari i komunës, z. Diamant Bytyqi, ka mbajtur takimin e rregullt, të tretin për këtë vit, ku u diskutua për gjendjen e sigurisë në komunën tonë.



Në këtë takim, nënkryetari Bytyqi tha se gjendja e sigurisë në Komunën e Lipjanit vazhdon të jetë e qetë dhe ka ftuar të gjithë të angazhohen në vazhdimësi që kjo situatë stabile e sigurisë të vazhdoj edhe më tutje.

Rrugët të cilat janë në menaxhim nga Ministria e Infrastrukturës:

Rruga Janjevë - Lipjan - Magurë – Sllatinë

Rruga Magurë - Blinaj

Rruga Magurë – Kleçkë


Rruga Komoran - Carralevë (e cila kalon në territorin e komunës së Lipjanit)

Rruga QMI - Shtime

Rruga QMI - Babush (që shkon për Ferizaj)

Dhe rruga Llugaxhi - Gadime - Bresalc :

Për shkak që shumë qytetarë po adresojnë kërkesat për sanim të prishjeve në rrugë, informojmë që këto rrugë të lartshënuara nuk janë në përgjegjësinë e komunës tonë.



Komuna nuk është përgjegjëse as për mirëmbajtjen verore e as atë dimërore

Kryetari Imri Ahmeti, vizitë zyrtare në Gostivar
Kryetari i Komunës së Lipjanit, z.Imri Ahmeti ka
qëndruar për vizitë zyrtare në Komunën e Gostivarit me
ç'rast është pritur nga Kryetari i kësaj komune z. Arben
Taravari.



Qëllimi i vizitës kishte të bëjë me thëllimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në fusha të ndryshme e me theks të veçantë në kulturë, sport, arsim etj.



“Është kënaqësi që me ftesë të Kryetarit z. Arben Taravarit, po qendroj për vizitë në komunën e Gostivarit, gjatë këtij takimi po shkëmbejmë përvoja të ndryshme të qeverisjes lokale e të cilat janë të shumta, si në fushën e zhvillimit ekonomik e deri tek arsimi, kultura e sporti të cilat janë tejet të rëndësishme për zhvillimin lokal. Unë e ftova kryetarin e Gostivarit z. Taravari që të vijë ta vizitoj Lipjanin dhe t'i shoh afër zhvillimet në qytetin tonë”, është shprehur Kryetari Ahmeti.

KPF zhvilloi punimet e mbledhjes së 16-të me radhë në sallën e takimeve në Komunën e Lipjanit është mbajtur mbledhja e 16 – të e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF).



Me këtë rast, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Daut Azemi, përveç pikave të parapara për këtë mbledhje, me propozim nga ekzekutivi ka propozuar dy pika shtesë për rendin e ditës.




Pas këtij ndryshimi, anëtarët e KPF-së, kanë shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës dhe i kanë rekomanduar për seancën e radhës të Kuvendit të Komunës që mbahet më 31 maj 2023.

Mbledhja e 19-të e Kuvendit të Komunës së Lipjanit 31.05.2023



Ndiqeni seancën drejtëpërdrejtë
<https://www.youtube.com/watch?v=yKPYcuz-M6M>

Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë